

## **"Ti je Perëndia që bën mrekulli": Historia e Zonjës Sonë në Çikago**

Mrekullitë ...sigurisht ne besojmë në to, sepse ato janë aq shumë pjesë e trashëgimisë sonë të krishterë ortodokse. Ungjijtë janë të mbushur me shumë raste të tilla. Megjithatë, kush mes nesh ndonjëherë do të kishte imagjinuar të ishte dëshmitar okular për diçka të "mrekullueshme"? Sa fort ne besojmë në mrekullitë e së kaluarës, po aq fort do të dyshonim në mundësinë e ndodhjes së tyre sot në shekullin e 21. Ato nuk mund të ndodhin tani ...jo më në Çikago, Illinois.

Besimtarët e Kishës Ortodokse Shqiptare të Shën Nikollës në Çikago ndanin të njëjtin qëndrim se këto gjëra nuk mund të ndodhin, të paktën, ky ishte mendimi deri para 6 Dhjetorit, 1986. Por diçka ndodhi atë mëngjes që nuk ndryshoi vetëm ndjenjat e tyre, por ndryshoi edhe jetët e tyre. Diçka e veçantë që pati një efekt të thellë mbi miliona njerëz të cilët që atëherë kanë ndarë përvojën e tyre shpirtërore mbi mrekullinë që u shpalos atë ditë. Ikona, tashmë e famshme e Hyjlindëses filloi të qajë.

Ky artikull nuk do të përpiqet të ofrojë shpjegime shkencore për këtë fenomen, as nuk do të përpiqet të sigurojë një interpretim teologjik se pse Virgjërësja derdhi lot. Kush mund të thotë me siguri se cili është qëllimi i Perëndisë, i cili n'a dha këtë shenjë të mrekullueshme? Qëllimi i vërtetë i autorit në artikullin e mëposhtëm është vetëm të dokumentojë këtë histori pothuajse të pabesueshme nga pikëpamja e atij që ka qenë i bekuar dhe i privilegjuar për të dëshmuar nga përvoja personale shumë aspekte të mrekullueshme të kësaj ngjarje.

### **Një zbulim i mahnitshëm**

Më 6 Dhjetor, 1986, prifti i kishës, Shumë i Nderuar Arkimandriti Filip Koufos mbërriti në kishë me një ndjenjë të mirë në zemrën e tij. Shërbimi i tij tre-vjeçar në komunitetin e kishës së Shën Nikollës i përbërë prej 250 familjesh, kishë e cila gjendet në anën veriperëndimore të Çikagos kishte filluar të jepte frytet e para. Ai ishte i kënaqur me ringjalljen e dukshme shpirtërore të besimtarëve. Padyshim rilindja e komunitetit të kishës kishte marrë udhë të mbarë. Kisha kishte qenë pothuajse plot një natë më parë në vigjilje të Ditës së Shenjtë të Shën Nikollës Mrekullibërësit. Ai parashikoi të njëjtën pjesëmarrje edhe sot që kisha do të festonte Diten e Shenjtë emrin e të cilit mbante.

Lillian George dhe Bessie Tolbert, dy anëtare të përkushtuara të kishës, gjithashtu kishin mbërritur në kishë më parë se të fillonin shërbesat fetare dhe po merreshin me disa përgatitje të minutave të fundit. Ndërkohë që At. Filipi po ndezte kandilet me vaj përballë ikonave në ikonostas, ai po sillte në mendje pjesë nga predikimi që kishte mbajtur një natë më parë. Në ligjëratën e tij, At. Filipi lartësoi vyrtet e shumta të Shën Nikollës, duke u përqëndruar në rolin e tij si mrekullibërës dhe shërues. Ai foli gjithashtu edhe për përgjegjësitë e mëdha të klerit të sotëm që të jenë gjithashtu "shërues".

Mendimet e At. Filipit u ndërpre në ndërkohë që filloi të ndizte kandilin përballë ikonës së Virgjërësës së Bekuar Maria. Ç'ishin ato rrëqe të njomura në ikonë? I befasuar, ai u bë gati të thërriste Lillian dhe Bessie, duke menduar që dikush kishte spërkatur pa dashje mbi këtë imazh të shenjtë të Nënës së Zotit. Por kur ai u përqëndrua dhe sytë e tij u përballën me sytë e

Virgjëreshës të pikturuar në ikonën përballë tij, menjëherë e kuptoi se rrëketë në ikonë nuk ishin shkaktuar nga ndonjë gabim në pastrim. Ato ishin lotët që buronin nga sytë e Virgjëreshës!

Me shikim të ngulitur dhe pa fjalë, për disa sekonda, mbi këtë pamje befasuese At. Filipi arriti të mbledhë veten dhe thirri të dy gratë që ndodheshin në anën e pasme të sallës së kishës. Ato me nxitim u afruan tek ikona dhe mbetën të befasuara nga pamja e ikonës së Virgjëreshës. Dhe sikur kjo pamje befasuese të mos ishte e mjaftueshme për treshen e çuditur, nga gishtërinjtë e Virgjëreshës filloi të dilte lageshti me çurqe, ç'ka e shtyu At. Filipin të binte në gjunjë përpara Ikonës së Shenjtë.

## **Ikona që qan**

Ikona që qan e Hyjlindëses në Kishën Ortodokse Shqiptare të Shën Nikollës është pikturuar gati gjysmë shekulli më parë nga ikonografi i njohur bizantin Youssis Konstantin. Në ikonografinë ortodokse, ka shumë lloje dhe stile të ikonave të Nënës së Perëndisë. Ikona e Virgjëreshës së Bekuar që ka fituar aq shumë vëmendje është imazhi i njohur si Hodigitria në greqisht, apo, në anglisht, Directress. Nëna e Zotit në këtë stil të ikonës është përshkruar si "ajo që tregon rrugën."

Sipas një tradite të lashtë të Kishës, ky stil i ikonës së Nënës së Bekuar i ka fillimet në një pikturë origjinale të saj bërë nga ungjillori Lluka. Është thënë se vetë Hyjlindësja i dha bekimin e saj për këtë portret, duke thënë: "Bekimi im do të mbetet gjithmonë mbi këtë ikonë." Shën Llukai është thënë se ka dërguar këtë ikonë, së bashku me tekstin e Ungjillit të tij, tek Theophilus në Antiok. Në mes të shekullit të 5-të, ky imazh i shenjtë u dërgua në qytetin e Konstandinopojës nga Perandoresha Eudoxia, si një dhuratë për vjehrrën e saj Pulcheria. Rreth shekullit të 9-të emri "Hodigitria" filloi të përdorej në lidhje me këtë pikturë të veçantë.

Në riprodhimin e kësaj ikone, Krishti Fëmijë gjithmonë paraqitet i mbajtur në krah të majtë të nënës së tij. Fëmija nuk tregohet më si një foshnje, por më tepër si një Perëndi e Përrjetshme, plot Urtësi. Ai mban një libër në dorën e majtë të Tij, dhe është duke dhënë një bekim me dorën e Tij të djathtë. Nëna e Perëndisë është portretizuar në një mënyrë madhështore. Dora e saj e djathtë është duke treguar djalin e saj, në një gjest solemn prezantimi. Duket sikur ajo është duke shpallur për njerëzimin që fëmija i saj është Biri i Perëndisë, Ai që ne duhet të ndjekim dhe t'i bindemi.

## **Hyjlindësja i përqafon të gjithë**

Që nga 6 Dhjetori 1986, është vlerësuar se më shumë se 2 milionë njerëz kanë ardhur në Kishën e Shën Nikollës për të parë Ikonën që qan. Hierarkë ortodoksë që përfaqësojnë pothuajse të gjitha juridiksionet në Shtetet e Bashkuara janë gjunjëzuar me modesti në lutje para Zonjës së Mrekullueshme.

Ikona që Qan është shumë e mirënjohur kudo. Ajo ka prekur jetët e shumë njerëzve dhe jo vetëm të Hierarkëve dhe personaliteteve të Kishës Ortodokse. Pelegrinët nga të gjitha sferat e jetës, të të gjitha moshave dhe të të gjitha besimeve kanë vizituar dhe janë kthyer përsëri në këtë Kishë modeste shqiptare për të parë shenjtën e mrekullueshme. Ata vijnë për arsye nga më

të ndryshmet. Disa vijnë nga kurioziteti. Të tjerët vijnë duke kërkuar për mrekulli në jetën e tyre. Ende të tjerë vijnë thjesht për t'u lutur dhe medituar para ikonës së Nënës së Zotit.

Grupe nga e gjithë Amerika e Veriut kanë ardhur për të vizituar e përjetuar këtë shenjë të mrekullueshme. At. Filipi dhe komuniteti i kishës së tij kanë mirëpritur grupe nga e gjithë Shtetet e Bashkuara dhe jashtë vendit. Jo pak herë, vizitorët kanë qenë të shumtë, por anëtarët e kësaj kisha të bekuar kanë vazhduar të mirëpresin ngrohtësisht të gjithë ata që hyjnë në kishën e tyre për të ndarë në gëzimin shpirtëror që kjo Ikonë ka sjellë në kaq shumë njerëz.

Në fjalët e At Filipit: "Ne kemi një thesar që Perëndia e ka besuar tek ne. Ne kështu kemi edhe më shumë përgjegjësi për të ndarë atë me të gjithë vëllezërit dhe motrat tona, qofshin ato ortodoksë, katolikë, apo protestantë. Sepse ndoshta, si një nënë që kërkon të sjellë paqe për familjen e saj, Nëna e Zotit, edhe tani, po ndihmon për të sjellë paqe për të gjithë familjen e atyre që nderojnë Birin e Saj."

Në Shtator 1988, është vërejtur lagështi në fytyrën e Virgjëreshës së Shenjtë dhe mbeti e dukshme për gati dy javë.

Më 23 Korrik 1995, Ikona Shenjtë filloi të qajë njëlloj si Ajo kishte bërë më 6 Dhjetor 1986.

### **Nga Paraklisi i Hyjlindëses së Përmbishenjtë**

Ti je gëzim për të pikëlluarit  
Dhe për të shtypurit, një mbrojtje,  
Dhe për të uriturit, ushqimi i tyre,  
Ngushëllim për të vetmuarit;  
Ti je një shkop për të verbërit,  
Pranë tek të gjithë të sëmurët,  
Dhe për ata që janë në dhimbje,  
Strehim dhe një ngushëllim,  
Dhe për jetimët, një ndihmë;  
Nëna e Perëndisë në më të lartë,  
Ti që je e Panjollëshme, nxito,  
Shpëtoi shërbëtorët e tu nga mëkati i tyre, ne të lusim.